



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 8, datë 18.07.2025

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 10:10

Data e mbajtjes së mbledhjes : 18.07.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Përshëndetje!

Të nderuar këshilltar! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës. Në këtë mbledhje siç jeni vënë në dijeni dhe nëpërmjet email-it të dërguar nga Sekretaria do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë ku pjesën më të madhe të tyre e zënë projektvendime në lidhje me fatkeqësinë natyrore të tërmetit të datës 26 nëntor 20219.

Ftoj sekretaren të procedojë me thirrjen e emrave të këshilltarëve.

Dritan Burgjia: Më falni përpara se të fillojë apelin mund të më japësh fjalën për procedurë.

Dorina Milja: Prit se nuk të është hapur mikrofon.

Denisa Luarasi: Të lutem mikrofonin!

Dritan Burgija: Shiko kemi disa mbledhje është bërë e zakonshme në këtë sallë të Këshillit Bashkiak në procedurat që ndiqen nga Bashkia Durrës që në momente të fundit na vijnë pika shitesë, kështu radhe ishte flagrante fare situata, ku na sillni në kohë sipas rregullores pikat e rendit të ditës pastaj hiqni 6 pika, pastaj 10 orë përpara domethënë mbasi kanë mbaruar dhe mbledhjet e komisioneve na shtoni dy pika të tjera. Kjo nuk është serioze, nuk është serioze për ne këtu në respekt të vetes tonë këtu, nuk është serioze edhe për ata që ne përfaqësojmë dhe ata që presin të marrin zgjidhje nga kjo sallë.

Tani duke qenë situatë e tillë, unë sot po ju them që në respekt të vetes dhe atyre që përfaqësojmë, jemi të gatshëm që të vijmë në çdo moment që na thirrni brenda, duke respektuar rregulloren e këtij këshilli, të vijmë një moment tjetër dhe të zgjidhim çdo hall të qytetarëve. Siç kam mbajtur qëndrimet në grup ku i keni lexu se çfarë kam shkrujt, kam thënë që : “....mund të sakrifikojmë nga orët tona pafund në shërbim të qytetarëve..”, por sot me keqardhje po ju them që ne do ta lëmë këtë sallë dhe do t’ju lejmë ta bëni vetë këtë mbledhje, nëse ju do bëni korumin dot. Në rregull?

Denisa Luarasi: Është e drejta juaj

Dritan Burgija: Është e drejta jonë një sekond se...

Denisa Luarasi: Por duke qenë pika, dy pika që janë për rindërtimin dhe janë sensitive për qytetetin tonë menduam që ti fusim, përderisa...

Dritan Burgija: Jo, për qytetin tonë të fusim më shumë se dy pika, por duke zbatuar rregulloren në kohë, jo 10 orë përpara mbledhjes ku asnjëri nga ne nuk ka kohë as të hapi email-in, jo më të ulët të lexojë diçka. Tani duke qenë se kjo u bë e zakonshme, madje po shkon përtej u bë e bezdisshme në çdo mbledhje që na trajtoni në këtë mënyrë. Ne do ta lejmë këtë sallë të gatshëm për të ardh në shërbim të Këshillit Bashkiak, në shërbim të qytetarëve në çdo moment tjetër.

Rolant Xhelilaj: Të dëgjoj dhe opinionin tonë zoti Burgija.

Desina Luarasi: Po, zoti Xhelilaj.

Dritan Burgija: Dëgjo ne nuk kemi çfarë opinion të dëgjojmë se e kemi dëgju kur ju.... Faleminderit.

Rolant Xhelilaj: Jo, jo e di pse duhet ta dëgjosh?

Denisa Luarasi: Për respekt...po për respekt....

Rolant Xhelilaj: E di pse duhet ta dëgjosh, dëgjoje se nuk shkon ajo ikje ashtu...

Denisa Luarasi: S'ka problem se dëgjojnë qytetarët.

Rolant Xhelilaj: Je njëçik si dizertor sot.

Puna është që këta nuk kanë lexuar rregulloren dhe flet në emër të rregullores, kjo është çudia më e madhe. Ne kemi qenë të gjithë dakort për të kërkuar një lloj konsensusi dhe me bashkinë që prurja e pikave të rendit të ditës të ketë një afat kohor për të krijuar mundësi komisioneve për të funksionuar normalisht, për të bërë atë që ato se kanë bërë për gati 2 vjet të lexojnë ndonjë projektligj, por gjithmonë kanë mbat qëndrime të karakterit politik dhe asnjëherë të karakterit që ndikon pozitivisht ose jo në zhvillimin e qytetit dhe plotësimin e kërkesave të komunitetit.

Në rregullore është e shkruar që në rendin e ditës me shumicë të anëtarëve të Këshillit Bashkiak futen dhe pikat, të cilat mendohen që kanë lidhje me mbledhjen, që kanë shpejtësi të domosdoshme kryerje të analizës tyre. Dhe derisa rregullorja e pranon një gjë të tillë mund të ngrihej pretendimi që është tejkaluar dhe kjo pikë e rregullores në shumë raste, por nuk mund të ngrehet pretendimi që po sakrifikon zoti Burgija me ato 4 vetë që kishte sot. Siç duket ai iku nga numri i pakët i njerëzve që kishte me vete, po sakrifikon për komunitetin, për qytetarët dhe po pranon pika, pikat i ka përcaktuar rregullorja.

Ne edhe gjatë periudhës 2 vjeçare kemi bërë një lloj propozimi, që unë mendoj ta ripërsërisim në shtator të ngrejmë një komision për rishikimin e rregullores dhe të përcaktojmë dhe disa gjëra të sakta fiks, të cilat mos të na lënë mundësinë të bëjmë komente politike. Deri sot jemi konform rregullores, kemi të drejtën me shumicë votash të anëtarëve të Këshillit Bashkiak të fusnim në rendin e ditës pika, që i konsiderojmë të domosdoshme dhe të rëndësishme që përputhen edhe me strukturën e mbledhjes.

Sot rruga e mbarë ju qoftë atyre. Ishte mbledhja e fundit, diçka do bënin në fund për të lënë shijen te qytetari që s'kanë interes për qytetin, s'kanë interes për zhvillimin normal të tij apo për punën e bashkisë. Duan të bëjnë politik, është politik e çuditshme, sepse nuk i dëgjon kush dhe nuk i shkon kush mbas.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Shifni pjesën tjetër në vazhdim...

Denisa Luarasi: Vazhdojmë...

Munir Konesha: Nuk është e drejtë që ju jepni fjalën pa hapur seancën, nuk është hapur akoma seanca

Denisa Luarasi: E kërkoi për procedurë.

Munir Konesha : Jo, jo një minutë nuk fillon pa hapur seanca, nuk i jepet fjala kërkujt, hapet seanca pastaj fillon.

Denisa Luarasi: Prandaj bëjmë ndryshimin ne, jemi më të mirë, tolerant.

Vazhdojmë. Dori të lutem me apelin.

Dorina Milja: Ardian Muka.....deri tek Florian Tahiri.
23 këshilltarë në sallë. Korumi nuk është i pranishëm.

Denisa Luarasi: Korumi nuk është i pranishëm, kështu që do të mbledhemi së shpejti, do njoftoheni nga Sekretaria, faleminderit.
Faleminderit dhe për përkushtimin tuaj por ...

Dorina Milja: Kryesia do të vendosi datën e mbledhjes dhe do të njoftoheni me email.

Elisabeta Mataj: S'bëhet?

Denisa Luarasi: Jo mbledhja nuk bëhet, nuk realizohet.
Mirutakofshim!

Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 4 (kater) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Drejtuesi i senacës plenare, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i proçesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Drejtues i senacës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) : DENISA LUARASI

Sekretar i Këshillit Bashkiak : DORINA MILJA

Këshilltar (Kr. Grupi PDIU) : FLORIAN TAHIRI

Këshilltar (Kr. Grupi PS) : ROLANT XHELILAJ

Këshilltar (Z/Kr. Grupi PS) : ANA DHAMO